Rezolutë

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur me vëmendje të veçantë fazën përmbyllëse të përgatitjeve për diskutimin e statusit të Kosovës,

- **duke përshëndetur** vendimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për fillimin e bisedimeve për përcaktimin e statusit të Kosovës;

- **duke vërejtur** progresin e dukshën në krijimin e bazave të një shoqërie të hapur dhe të konsolidimit të shtetit ligjor në Kosovë, pasqyruar edhe në raportin "Aide";

- **duke vlerësuar** përpjekjet e institucioneve të Kosovës, Presidentit, Kuvendit, Qeverisë, partive politike dhe banorëve të Kosovës në ndërtimin e një Kosove demokratike e multietnike;

- **duke falënderuar** bashkësinë ndërkombëtare dhe në veçanti NATO-n, për angazhimin në përballimin e krizës kosovare, si dhe UNMIK-un, KFOR-in dhe OSBE-në për kontributin në stabilizimin gradual të situatës në vend, si dhe në ndërtimin e institucioneve;

- **duke shprehur** bindjen se roli i bashkësisë ndërkombëtare do të vazhdojë të mbetet esencial edhe në të ardhmen për një Kosovë të integruar në strukturat europiane dhe auroatlantike;

- **duke nënvizuar** nevojën e kalimit nga statusi aktual në krijimin e një shteti të ngritur mbi parimet ndërkombëtare të paqes sociale, sundimit të ligjit e bashkëjetesës multietnike;

- **duke vlerësuar** rolin shumëplanësh të Shqipërisë qysh në përballimin e krizës politike, humanitare në Kosovë, si dhe në sigurimin e vazhdueshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon;

- **duke inkurajuar** e mbështetur nisma e projekte konkrete të Qeverisë, që do të ndihmonin zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Kosovës, si dhe do të intensifikonin dialogun dypalësh e shumëpalësh në rajon;

- **duke mbështetur** vullnetin e lirë të popullit të Kosovës, i cili tashmë është shprehur për pavarësi;

- **duke vlerësuar** rëndësinë që kanë qëndrimet e shtetit shqiptar për zhvillimet në Kosovë;

- **mbetet i angazhuar** në veprimin e tij politik diplomatik gjatë gjithë periudhës së negociatave për përcaktimin e statusit të Kosovës;

- **shpreson fuqishëm** se nga procesi i bisedimeve do të dalë një rezultat i qëndrueshëm, i cili reflekton aspiratat dhe vullnetin e lirë të qytetarëve të Kosovës për një shtet të pavarur, demokratik, europian;

- **u kërkon** institucioneve shtetërore dhe fton organizatat e shoqërisë civile dhe mediat të dëshmojnë kohezion dhe përgjegjësi gjatë këtyre zhvillimeve.

Tiranë, më 21 nëntor 2005